

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 132 Prot.

Tiranë, më 30.01 2017

VENDIM Nr. 17, datë 24.01.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 1 të datës 24.01.2017, pasi shqyrtoi *Raportin e gërmimit të hapur arkeologjik të shpëtimit*, në sheshin e grumbullimit të tubave APY03. fshati Qafë-Çorovodë, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k..

VENDOSI:

1. Të miratojë Raportin e gërmimit të hapur arkeologjik të shpëtimit, në sheshin e grumbullimit të tubave APY03. fshati Qafë-Çorovodë, paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k.
2. Shoqëri e licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k., të marrë masat për rehabilitimin e zonës.
3. Të vijojnë punimet e ndërtimit të tubacionit të Linjës së gazjellësit TAP, sipas akt-marrëveshjes tre palëshe, të lidhur ndërmjet "TAP AG", shoqërisë së licencuar në arkeologji "ABKONS" sh.p.k. dhe ASHA, të përcaktuar në pikën 2 të vendimit të KKA Nr. 74, datë 28.06.2016, për Raportin e Vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor për Stacionet e Valvolave Bllokuese, Sheshet e Magazinimit të Tubave dhe Kampet e Punëtorëve (20 objekte), në kuadër të projektit "TAP"-shoqëria TAP-AG.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO